



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 1073/prot.
1

Tiranë, më 19.12.2025

VENDIM

Nr. 1249, Datë 19.12.2025

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRJASHTIMIN NË BLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE
VERTIKALE DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rregullorja Nr. 234, datë 19.07.2012 “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar	Fatjola DELIJA  Anëtar
---	---	--	--

Denar BIBA


Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

RREGULLORE

“PËR PËRJASHTIMIN NË BLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE
DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”¹

Neni 1

Objekti

1. Kjo Rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve që duhet të përmbushin marrëveshjet vertikale për të përfituar nga përjashtimi nga ndalimi i nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (referuar në vijim si “Ligji”), në përputhje me nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.
2. Përfitimi i përjashtimit në bllok i vendosur nga kjo Rregullore kufizohet në marrëveshjet vertikale për të cilat mund të supozohet me siguri të mjaftueshme se plotësojnë kushtet e nenit 5 dhe 6 të Ligjit.
3. Kjo Rregullore nuk përjashton kufizimet për të cilat nuk mund të supozohet me siguri të mjaftueshme se plotësojnë kushtet e nenit 5 dhe 6 të Ligjit.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - a) “*marrëveshje vertikale*” do të thotë një marrëveshje ose praktikë e bashkërenduar ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, secila prej të cilave vepron, për qëllimet e marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm të zinxhirit të prodhimit ose shpërndarjes, dhe në lidhje me kushtet sipas të cilave palët mund të blejnë, shesin ose rishesin mallra ose shërbime të caktuara;
 - b) “*kufizim vertikal*” do të thotë një kufizim i konkurrencës në një marrëveshje vertikale që bie në objektin e nenit 4 të Ligjit;
 - c) “*ndërmarrje konkurruese*” do të thotë një konkurrent aktual ose potencial;
 - (i) “konkurrent aktual” do të thotë një ndërmarrje që është aktive në të njëjtin treg përkatës;
 - (ii) “konkurrent potencial” do të thotë një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes vertikale, do të kishte gjasa, në baza reale dhe jo thjesht si një mundësi teorike, brenda një periudhe të shkurtër kohe, të kryente investimet e nevojshme shtesë ose të përballonte kostot e tjera të nevojshme për të hyrë në tregun përkatës;
 - d) “*furnizues*” përfshin një ndërmarrje që ofron shërbime ndërmjetësimi në internet;
 - e) “*shërbimet e ndërmjetësimit në internet*” do të thotë shërbimet e shoqërisë së informacionit sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 50, i Ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet

¹ (32022R0720) Rregullorja e Komisionit (BE) 2022/720 e datës 10 maj 2022 mbi zbatimin e Nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara (Tekst me rëndësi për EEA-në) C/2022/3015 OJ L 134, 11.5.2022, f. 4–13

elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat i lejojnë ndërmarrjet t’iu ofrojnë mallra ose shërbime:

- (i) ndërmarrjeve të tjera, me synimin për të lehtësuar fillimin e transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre ndërmarrjeve, ose
 - (ii) konsumatorëve fundorë, me synimin për të lehtësuar fillimin e transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre ndërmarrjeve dhe konsumatorëve fundorë,
- pavarësisht nëse dhe ku përfundohen transaksionet;
- f) “*detyrim për mos konkurruar*” do të thotë çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që shkakton që blerësi të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime që konkurrojnë me mallrat ose shërbimet e kontratës, ose çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi blerësin për të blerë nga furnizuesi ose nga një ndërmarrje tjetër e caktuar nga furnizuesi më shumë se 80% të blerjeve totale të blerësit të mallrave ose shërbimeve të kontratës dhe zëvendësuesve të tyre në tregun përkatës, të llogaritura në bazë të vlerës ose, kur është praktikë standarde e industrisë, vëllimin e blerjeve të tij në vitin kalendarik paraardhës;
 - g) “*sistem i shpërndarjes përzgjedhëse*” do të thotë një sistem shpërndarjeje ku furnizuesi merr përsipër t’ia shesë mallrat ose shërbimet e kontratës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetëm shpërndarësve të përzgjedhur në bazë të kriterëve të veçanta dhe ku këta shpërndarës marrin përsipër mos t’ia shesin këto mallra ose shërbime shpërndarësve të paautorizuar brenda territorit të rezervuar nga furnizuesi për të zbatuar atë sistem;
 - h) “*sistem i shpërndarjes ekskluzive*” do të thotë një sistem shpërndarjeje ku furnizuesi rezervon një territor ose grup klientësh ekskluzivisht për vete ose për një maksimum prej pesë blerësish dhe i kufizon të gjithë blerësit e tjerë të tij që të shesin aktivisht në territorin ekskluziv ose tek grupi ekskluziv i klientëve;
 - i) “*të drejtat e pronësisë intelektuale*” përfshijnë të drejtat e pronësisë industriale, *know-how*-un, të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to;
 - j) “*know-how*” do të thotë një paketë informacioni praktik i papatentuar, që është rezultat i përvojës dhe testimit nga furnizuesi, i cili është sekret, thelbësor dhe i identifikuar;
 - (i) “sekret” do të thotë se *know-how* nuk është përgjithësisht i njohur ose lehtësisht i arritshëm;
 - (ii) “thelbësor” do të thotë se *know-how* është i rëndësishëm dhe i dobishëm për blerësin për përdorimin, shitjen ose rishitjen e mallrave ose shërbimeve të kontratës;
 - (iii) “i identifikuar” do të thotë që *know-how* përshkruhet në një mënyrë mjaftueshëm të plotë, në mënyrë që të mundësohet verifikimi i plotësimi të kriterëve të të qenit sekret dhe thelbësor;
 - k) “*blerës*” përfshin një ndërmarrje e cila, sipas një marrëveshjeje që bie në objektin e nenit 4 të Ligjit, shet mallra ose shërbime në emër të një ndërmarrjeje tjetër;
 - l) “*shitje aktive*” do të thotë shënjestrimi aktiv i klientëve nëpërmjet vizitave, letrave, postës elektronike, thirrjeve ose mjeteve të tjera të komunikimit të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet reklamave dhe promociioneve të synuara, pa internet ose në internet, për shembull me anë të mediave të shkruara ose digjitale, duke përfshirë mediat në internet, shërbimet e krahasimit të çmimeve ose reklamimit në motorët e kërkimit që shënjestrojnë klientë në territore të veçanta ose grupe klientësh, operimin e një faqe interneti në një domen të nivelit të lartë që korrespondon me territore të veçanta, ose ofrimin në një faqe interneti gjuhë që përdoren zakonisht në territore të veçanta, ku gjuhë të tilla janë të ndryshme nga ato që zakonisht përdoren në territorin në të cilin është vendosur blerësi;
 - m) “*shitje pasive*” do të thotë shitjet e bëra në përgjigje të kërkesave të pasynuara nga klientët individë, duke përfshirë shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve për klientin, ku shitja nuk

është filluar duke shënjestruar aktivisht klientin, grupin ose territorin e klientëve të caktuar dhe duke përfshirë shitjet që rezultojnë nga pjesëmarrja në prokurimet publike ose përgjigjja ndaj ftesave private për tender;

- n) *"Komisioni i Konkurrencës"* do të thotë struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës.
2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termit *"ndërmarrje"*, *"furnizues"* dhe *"blerës"* do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura.

"Ndërmarrje të lidhura" do të thotë:

- a) ndërmarrjet tek të cilat një palë në marrëveshje, drejtpërdrejt ose tërthorazi:
- (i) ka kompetencat për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose
 - (ii) ka kompetencat për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, këshillit të administrimit ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen, ose
 - (iii) ka të drejtë të administrojë veprimtarinë e ndërmarrjes; ose
- b) ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshje, të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a); ose
- c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në germën b) ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a); ose
- d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshje së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në germat a), b) ose c), ose në të cilat dy ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në germat a), b) ose c), kanë së bashku të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a); ose
- e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a) mbahen bashkërisht nga:
- (i) palët në marrëveshje ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura të përmendura në germat a) deri d), ose
 - (ii) një ose më shumë nga palët në marrëveshje ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në germat a) deri d) dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 3

Përjashtimi

1. Në bazë të nenit 5 dhe 6 të Ligjit dhe në varësi të dispozitave të kësaj Rregulloreje, neni 4 i Ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale. Ky përjashtim do të zbatohet në masën që këto marrëveshje përmbajnë kufizime vertikale.
2. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet një grupi ndërmarrjesh dhe një anëtari individual të këtij grupi, ose ndërmjet një grupi të tillë dhe një furnizuesi individual, vetëm nëse të gjithë ndërmarrjet anëtare të grupit janë shitës me pakicë të mallrave dhe nëse asnjë ndërmarrje anëtare e grupit, së bashku me ndërmarrjet e lidhura me të, nuk ka një xhiro totale vjetore që tejkalon 400 milionë lekë. Marrëveshjet vertikale të lidhura nga grupe të tilla do të bien në objektin e kësaj Rregulloreje pa çënuar zbatimin e nenit 4 të Ligjit për marrëveshjet horizontale të lidhura ndërmjet anëtarëve të grupit ose vendimet e miratuara nga grupi.
3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 zbatohet për marrëveshjet vertikale që përmbajnë dispozita që lidhen me transferimin tek blerësi ose përdorimin nga blerësi të të drejtave të pronësisë intelektuale, me kusht që këto dispozita të mos përbëjnë objektin kryesor të këtyre marrëveshjeve

dhe janë drejtpërdrejt të lidhura me përdorimin, shitjen ose rishitjen e mallrave ose shërbimeve nga blerësi ose klientët e tij. Përfashtimi zbatohet me kushtin që, në lidhje me mallrat ose shërbimet e kontratës, këto dispozita të mos përmbajnë kufizime të konkurrencës që kanë të njëjtin objekt si kufizimet vertikale, të cilat nuk përfashtohen sipas kësaj Rregulloreje.

4. Përfashtimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve konkurrense. Megjithatë, ky përfashtim do të zbatohet kur ndërmarrjet konkurrense hyjnë në një marrëveshje vertikale jo të ndërsjellë dhe zbatohet një nga sa vijon:
 - a) furnizuesi është aktiv në rrjedhën e sipërme si prodhues, importues ose tregtar me shumicë dhe në rrjedhën e poshtme si importues, tregtar me shumicë ose pakicë i mallrave, ndërsa blerësi është importues, tregtar me shumicë ose me pakicë në rrjedhën e poshtme dhe jo ndërmarrje konkurrense në rrjedhën e sipërme ku blen mallrat e kontratës; ose
 - b) furnizuesi është një ofrues i shërbimeve në disa nivele të tregtisë, ndërsa blerësi ofron shërbimet e tij në nivelin e shitjes me pakicë dhe nuk është një ndërmarrje konkurrense në nivelin e tregtisë ku blen shërbimet e kontratës.
5. Përfashtimet e përcaktuara në paragrafin 4, gerrat a) dhe b) nuk do të zbatohen për shkëmbimin e informacionit ndërmjet furnizuesit dhe blerësit që nuk lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e marrëveshjes vertikale ose nuk është i nevojshëm për të përmirësuar prodhimin ose shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve të kontratës, ose që nuk përmbush asnjë nga këto dy kushte.
6. Përfashtimet e përcaktuara në paragrafin 4, gerrat a) dhe b) nuk do të zbatohen për marrëveshjet vertikale të lidhura me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në internet ku ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit në internet është një ndërmarrje konkurrense në tregun përkatës për shitjen e mallrave ose shërbimeve të ndërmjetësuar.
7. Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale, objekti i të cilave bie në objektin e ndonjë rregulloreje tjetër të përfashtimit në bllok, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në një rregullore të tillë.

Neni 4

Pragu i pjesës së tregut

1. Përfashtimi i parashikuar në nenin 3 zbatohet me kusht që pjesa e tregut që zotërohet nga furnizuesi të mos kalojë 30% të tregut përkatës në të cilin ai shet mallrat ose shërbimet e kontratës dhe pjesa e tregut që zotërohet nga blerësi të mos kalojë 30% të tregut përkatës në të cilin ai blen mallrat ose shërbimet e kontratës.
2. Për qëllimet e paragrafit 1, kur në një marrëveshje shumëpalëshe një ndërmarrje blen mallrat ose shërbimet e kontratës nga një ndërmarrje që është palë në marrëveshje dhe ia shet mallrat ose shërbimet e kontratës një ndërmarrjeje tjetër që është gjithashtu palë në marrëveshje, pjesa e tregut e ndërmarrjes së parë duhet të mos kalojë prapun e pjesës së tregut të parashikuar në atë paragraf qoftë si blerës ashtu edhe si furnizues, në mënyrë që të zbatohet përfashtimi i parashikuar në nenin 3.

Neni 5

Kufizimet që heqin përfitimin e përfashtimit në bllok – kufizimet e rënda

Përfashtimi i parashikuar në nenin 3 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt:

1. kufizimin e aftësisë së blerësit për të përcaktuar çmimin e tij të shitjes, pa cënuar mundësinë e furnizuesit për të vendosur një çmim maksimal shitje ose për të rekomanduar një çmim shitje, me kusht që ato të mos përbëjnë një çmim fiks ose minimal të shitjes si rezultat i presionit nga, ose stimuljt e ofruar nga, ndonjëra prej palëve;

2. kur furnizuesi operon një sistem të shpërndarjes ekskluzive, kufizimin e territorit në të cilin ose të klientëve të cilëve, shpërndarësi ekskluziv mund të shesë aktivisht ose pasivisht mallrat ose shërbimet e kontratës, përveç:
 - a) kufizimit të shitjeve aktive nga shpërndarësi ekskluziv dhe klientët e tij të drejtpërdrejtë, në një territor ose në një grup klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të përcaktuar nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpërndarësve të tjerë ekskluzivë;
 - b) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive nga shpërndarësi ekskluziv dhe klientët e tij ndaj shpërndarësve të paautorizuar të vendosur në një territor ku furnizuesi operon një sistem të shpërndarjes përzgjedhëse për mallrat ose shërbimet e kontratës;
 - c) kufizimit të vendndodhjes së selisë së shpërndarësit ekskluziv;
 - d) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive ndaj përdoruesve fundorë nga një shpërndarës ekskluziv që vepron në nivelin e tregtisë me shumicë;
 - e) kufizimit të aftësisë së shpërndarësit ekskluziv për të shitur aktivisht ose pasivisht pjesë, të furnizuara për qëllime montimi, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëjtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;
3. ku furnizuesi operon një sistem të shpërndarjes përzgjedhëse,
 - a) kufizimin e territorit në të cilin, ose klientëve të cilëve, anëtarët e sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse mund t'u shesin aktivisht ose pasivisht mallrat ose shërbimet e kontratës, përveç:
 - (i) kufizimit të shitjeve aktive nga anëtarët e sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse dhe klientët e tyre të drejtpërdrejtë, në një territor ose në një grup klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të përcaktuar nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpërndarësve ekskluzivë;
 - (ii) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive nga anëtarët e sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse dhe klientët e tyre ndaj shpërndarësve të paautorizuar të vendosur brenda territorit ku operohet sistemi i shpërndarjes përzgjedhëse;
 - (iii) kufizimit të vendndodhjes së selisë së anëtarëve të sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse;
 - (iv) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive ndaj përdoruesve fundorë nga anëtarët e sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse që vepron në nivelin e tregtisë me shumicë;
 - (v) kufizimit të aftësisë për të shitur aktivisht ose pasivisht pjesë, të furnizuara për qëllime montimi, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëjtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;
 - b) kufizimin e furnizimeve të ndërsjella ndërmjet anëtarëve të sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse që veprojnë në të njëjtat ose nivele të ndryshme tregtie;
 - c) kufizimin e shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga anëtarët e sistemit të shpërndarjes përzgjedhëse që veprojnë në nivelin e tregtisë me pakicë, pa cënuar paragrafin 3, germa a), pikat (i) dhe (iii);
4. kur furnizuesi nuk operon as një sistem të shpërndarjes ekskluzive dhe as një sistem të shpërndarjes përzgjedhëse, kufizimin e territorit në të cilin, ose klientëve të cilëve, blerësi mund t'u shesë aktivisht ose pasivisht mallrat ose shërbimet e kontratës, përveç:
 - a) kufizimit të shitjeve aktive nga blerësi dhe klientët e tij të drejtpërdrejtë në një territor ose një grupi klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të përcaktuar nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpërndarësve ekskluzivë;
 - b) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive nga blerësi dhe klientët e tij ndaj shpërndarësve të paautorizuar të vendosur në një territor ku furnizuesi operon një sistem të shpërndarjes përzgjedhëse për mallrat ose shërbimet e kontratës;
 - c) kufizimit të vendndodhjes së selisë së blerësit;

- d) kufizimit të shitjeve aktive ose pasive ndaj përdoruesve fundorë nga një blerës që operon në nivelin e tregtisë me shumicë;
 - e) kufizimit të aftësisë së blerësit për të shitur aktivisht ose pasivisht pjesë, të furnizuara për qëllime montimi, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëjtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;
5. parandalimin e përdorimit efektiv të internetit nga blerësi ose klientët e tij për të shitur mallrat ose shërbimet e kontratës, për arsye se kufizon territorin në të cilin ose klientët të cilëve mallrat ose shërbimet e kontratës mund t'u shiten sipas kuptimit të paragrafëve 2, 3 ose 4, pa cënuar mundësinë e imponimit ndaj blerësit:
- a) kufizime të tjera të shitjeve në internet; ose
 - b) kufizime të reklamimit në internet që nuk kanë si objekt pengimin e përdorimit të një kanali të tërë reklamimi në internet;
6. kufizimin, e rënë dakord midis një furnizuesi pjesësh dhe një blerësi që monton këto pjesë, e aftësisë së furnizuesit për t'i shitur pjesët si pjesë këmbimi për përdoruesit përfundimtarë ose riparuesit, shitësit me shumicë ose ofruesit e tjerë të shërbimit të cilëve nuk u është besuar nga blerësi riparimi ose mirëmbajtja e mallrave të tij.

Neni 6

Kufizimet të tjera

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 3 nuk zbatohet për detyrimet e mëposhtme të përfshira në marrëveshjet vertikale:
 - a) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë për mos konkurruar, kohëzgjatja e të cilit është e pacaktuar ose i kalon 5 vjet;
 - b) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që bën që blerësi, pas përfundimit të marrëveshjes, të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime;
 - c) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që bën që anëtarët e një sistemi të shpërndarjes përzgjedhëse të mos shesin markat e furnitorëve të veçantë konkurrues;
 - d) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që bën që një blerës i shërbimeve të ndërmjetësimit në internet të mos u ofrojë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime përdoruesve fundorë me kushte më të favorshme nëpërmjet shërbimeve konkurruese të ndërmjetësimit në internet;
2. Si përjashtim nga paragrafi 1, germa a), kufizimi kohor prej pesë vitesh nuk do të zbatohet kur mallrat ose shërbimet e kontratës shiten nga blerësi nga ambientet dhe tokat në pronësi të furnizuesit ose të marra me qira nga furnizuesi nga palë të treta që nuk janë të lidhura me blerësin, me kusht që kohëzgjatja e detyrimit për mos konkurruar të mos kalojë periudhën e përdorimit të ambienteve dhe tokave nga blerësi.
3. Si përjashtim nga paragrafi 1, germa b), përjashtimi i parashikuar në nenin 3 do të zbatohet për çdo detyrim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që bën që blerësi, pas përfundimit të marrëveshjes, të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) detyrimi lidhet me mallrat ose shërbimet që konkurrojnë me mallrat ose shërbimet e kontratës;
 - b) detyrimi kufizohet në ambientet dhe tokën nga e cila blerësi ka vepruar gjatë periudhës së kontratës;
 - c) detyrimi është i domosdoshëm për të mbrojtur *know-how*-un e transferuar nga furnizuesi te blerësi;

- d) kohëzgjatja e detyrimit është e kufizuar në një periudhë prej një viti pas përfundimit të marrëveshjes.

Paragrafi 1, germa b) nuk cenon mundësinë e vendosjes së një kufizimi të pakufizuar në kohë për përdorimin dhe zbulimin e *know-how*-ut që nuk ka hyrë në domenin publik.

Neni 7

Revokimi në raste individuale

1. Në përputhje me nenet 48 deri 51 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përjashtimin sipas kësaj Rregulloreje, nëse konstaton se një marrëveshje vertikale së cilës i zbatohet përjashtimi i nenit 3 i kësaj Rregulloreje ka gjithsesi efekte që janë të papajtueshme me nenin 5 dhe 6 të Ligjit. Efekte të tilla mund të ndodhin, për shembull, kur tregu përkatës për furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në internet ka përqëndrim të lartë dhe konkurrenca midis ofruesve të shërbimeve të tilla kufizohet nga efekti kumulativ i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme që kufizojnë blerësit e shërbimeve të ndërmjetësimit në internet nga ofrimi, shitja ose rishitja e mallrave ose shërbimeve për përdoruesit fundorë në kushte më të favorshme në kanalet e tyre të shitjes të drejtpërdrejtë.
2. Kur Komisioni i Konkurrencës revokon përfitimin e kësaj Rregulloreje, ai ka barrën të provojë se marrëveshja vertikale në fjalë bie në objektin e nenit 4 të Ligjit dhe se marrëveshja nuk arrin të plotësojë të paktën një nga kushtet e nenit 5 dhe 6 të Ligjit.

Neni 8

Moszbatimi i kësaj Rregulloreje

Kjo Rregullore nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale që përmbajnë kufizime specifike në lidhje me një treg përkatës, kur rrjetet paralele të kufizimeve vertikale të ngjashme mbulojnë më shumë se 50% të atij tregu.

Neni 9

Zbatimi i pragut të pjesës së tregut

Për qëllime të zbatimit të pragjeve të pjesës së tregut të parashikuara në nenin 4, zbatohen rregullat e mëposhtme:

1. pjesa e tregut e furnizuesit llogaritet në bazë të të dhënave të vlerës së shitjeve në treg dhe pjesa e tregut të blerësit llogaritet në bazë të të dhënave të vlerës së blerjeve në treg. Nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg ose të vlerës së blerjeve në treg nuk janë të disponueshme, vlerësimet e bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë vëllimet e shitjeve dhe blerjeve në treg, mund të përdoren për të përcaktuar pjesën e tregut të ndërmarrjes në fjalë;
2. pjesët e tregut llogariten në bazë të të dhënave të vitit kalendarik paraardhës;
3. pjesa e tregut e furnizuesit përfshin çdo mall ose shërbim që i është furnizuar shpërndarësve të integruar vertikalisht për qëllime të shitjes;
4. nëse një pjesë e tregut fillimisht nuk është më e madhe se 30%, por më pas rritet mbi atë nivel, përjashtimi i parashikuar në nenin 3 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarike radhazi pas vitit në të cilin është tejkaluar për herë të parë pragu prej 30%;
5. pjesa e tregut e zotëruar nga ndërmarrjet e përmendura në nenin 2, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germa e) do t'i ndahet në mënyrë të barabartë secilës ndërmarrje që ka të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a) të atij nënparagrafi.

Neni 10

Zbatimi i pragut të xhiros

1. Për qëllimin e llogaritjes së xhiros totale vjetore sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 2, xhiroja e realizuar gjatë vitit financiar të mëparshëm nga pala përkatëse në marrëveshjen vertikale dhe xhiroja e realizuar nga ndërmarrjet e lidhura me të në lidhje me të gjitha mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera, do të mbledhen së bashku. Për këtë qëllim, nuk do të merren parasysh marrëdhëniet ndërmjet palës në marrëveshjen vertikale dhe ndërmarrjeve të lidhura me të ose ndërmjet ndërmarrjeve të lidhura me të.
2. Përfshirja e parashikuar në nenin 3 do të mbetet i zbatueshëm kur, për çdo periudhë prej dy vitesh financiare radhazi, pragu i xhiros totale vjetore tejkalohet me jo më shumë se 10%.

Neni 11

Periudha kalimtare

Ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nuk do të zbatohet gjatë periudhës prej një viti duke filluar tre javë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje në lidhje me marrëveshjet që janë në fuqi tre javë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të cilat nuk plotësojnë kushtet për përfshirje të parashikuara në këtë Rregullore, por të cilat, tre javë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, plotësonin kushtet për përfshirje të parashikuara në Rregulloren "*Për përfshirjen në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara*", të miratuar me vendimin Nr. 234, datë 19 korrik 2012, të Komisionit të Konkurrencës.

Neni 12

Shfuqizime

Rregullorja "*Për përfshirjen në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara*", e miratuar me vendimin Nr. 234, datë 19 korrik 2012, të Komisionit të Konkurrencës, shfuqizohet.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.